

Së bashku sot në Durrës duke informuar qytetarët mbi të drejtat ligjore.

Takim mjaft interesant me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve të Bashkisë Durrës, NJMF Sukth, Njësisë Administrative Rrashbull, Njësisë Administrative nr.2, Njësisë Administrative Nr.5, Administratorëve të këtyre njësive, Njësisë Katund i Ri, NJMF së bashkisë Durrës, përfaqësuesëve të komunitetit rom dhe egjiptian, përfaqësues të organizatave CSDC, Së bashku në Komunitet për zhvillimin e shoqërisë, Projektit ESERE të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD, përfaqësues të Prefekturës Durrës, përfaqësues të Qendrës Komunitare “Sot për të Ardhmen”, QDM, Qendrës Komunitare Nishtulla, organizatës Ushten, organizatës Qëndistaret, Shoqatës së Grave me Probleme Sociale, organizatës Shpresa e Gjallë, studentëve dhe pedagogëve të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, pranë Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës, juristë të klinikës ligjore të ngritur pranë këtij Universiteti, psikologëve, avokateve të Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, avokateve të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, përfituese të shërbimit ligjor falas, etj.

Pjesëmarrësit u informuan mbi shërbimet që ofron Qendra e Ndhmës Ligjore Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Durrës, çështje të aksesit të viktimave të dhunës me bazë gjinore në sistemin e drejtësisë sipas ligjit 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, të drejtat e viktimave të krimit të parashikuara në ligjin nr. 35/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, etj.

Takimi u shoqërua me pyetje të pjesëmarrësve në lidhje me probleme me përfitimin e ndihmës ekonomike, kushtet e përfitimit të ndihmës ligjore falas, objektin e çështjeve për të cilat avokatet e Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas ofrojnë mbështetje, mbështetje të të moshuarëve në qendrën komunitare në lidhje me të drejtat e tyre pronësore, identifikimin e situatave diskriminuese në arsim, ndarjen e vlerësimit nga përfitueset e shërbimit ligjor për avokatet e Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, etj.

Në përfundim të takimit u diskutua edhe për angazhimin e studentëve të trajnuar në edukimin ligjor të qytetarëve pranë njësive administrative në Durrës, me qëllim rritjen e numrit të përfituesëve. Shpresojmë që rezultatet e aktivitetit të maten me më shumë individë nga njësitë administrative që do të kërkojnë ndihmë ligjore falas pranë avokateve të Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas në Durrës.

Aktiviteti u organizua në kuadrin e projektit “Fuqizimi i grupeve të varfra dhe të marginalizuara përmes ofrimit të ndihmës juridike falas dhe edukimit ligjor, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD Shqipëri.